



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
TIRANA PARKING
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Tiranë , më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[Data]: 03.09.2024

Drejtuar: **Tirana Auto Shpk** me adresë: Tiranë Kashar Autostrada Tiranë Durrës, Kilometri 1, Rruga Dytësore.

Procedura e prokurimit: “E Hapur”

Numri i procedurës: **REF-15514-08-06-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Blerje mjete transporti (automjete elektrike dhe mjet pick-up)**”.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.47 datë 12 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “**Tirana Auto**” Shpk

K82318007Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera : **12 000 000** (dymbëdhjetë milion) **lekë pa Tvsh.**

2. “**Compitel**” Shpk

M31417021V

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **12 000 000** (dymbëdhjetë milion) **lekë pa Tvsh.**

3. **“Classic” Shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

J91909004J
Numri i NIPT-t

Vlera: **12 400 000** (dymbëdhjetë milion e katërqind) **lekë pa Tvsh.**

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“Classic” Shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

J91909004J
Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme;

1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës
2. Katalogu (Maxus T90 EV dhe Ssangyoung Korando) Katalogu i automjetit Maxus T90 EV Pickup është paraqitur në gjuhë të huaj, i pashoqeruar me perkthimin në gjuhën shqip, sikurse është percaktuar në kërkesat për kualifikim, perkatesisht në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik. Si rrjedhojë nuk mund kryhet verifikimi i specifikimeve që përmban automjeti në raport me specifikimet teknike të percaktuara në DST.
Katalogu i paraqitur Ssangyoung Korando) nuk përmban të dhëna në lidhje me kategorinë e automjetit
Katalogu i paraqitur nuk përmban të dhëna në lidhje me kapacitetin e baterive
Katalogu i paraqitur nuk përmban të dhëna në lidhje me peshën mbajtëse të automjetit (pesha me ngarkesë) por përmban vetëm peshën boshe të automjetit

2. **“Compitel” Shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

M31417021V
Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme;

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.1 në dokumentat standart të tenderit konkretisht; Ka dorëzuar vetëm bilancin e vitit 2023, pasi është themeluar si subjekt në vitin 2023. Ka paraqitur një deklaratë të leshuar nga administratori ku shpjegon faktin që si subjekt i krijuar në vitin 2023 nuk disponon bilancin e vitit 2022
2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2 në dst konkretisht; Nga shyrtimi I certificates Iso 9001:2015 me nr. SMC20240328ALCS, e leshuar nga OVK “E CERT” Sh.p.k, rezulton se certifikata është leshuar fillimisht me 28 Mars 2023 dhe në vijim është rilesuar në datën 23 Mars 2024, mbas auditimit mbikqyres me të dhënat e rifreskuara.

Nga verifikimi I kryer në regjistrin elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, <https://dpa.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/E-Cert-shpk-15-11-2023.pdf>, rezulton se “E CERT” Sh.p.k është akredituar si organizëm certifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të cilësisë në përputhje me: ISO 9001:2015 në datën 09.11.2023, në bazë të certifikatës së akreditimit me nr. CS 013.

Nga krahasimi I dates së leshimit të certificates ISO 9001:2015 me nr. SMC20240328ALCS, e leshuar nga subjekti “E CERT” Sh.p.k me datën e akordimit të akreditimit të këtij subjekti si organizëm certifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të cilësisë në përputhje me: ISO 9001:2015, rezulton se certifikata me nr. SMC20240328ALCS, e paraqitur

nga operatori Compitel Sh.p.k është leshuar nga subjekti “E CERT” Sh.p.k para se ky i fundit të akreditohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si një organizem certifikimi për standartin ISO 9001:2015.

Si rrjedhojë certifikata ISO 9001:2015 me nr. SMC20240328ALCS është leshuar nga një subjekt i cili nuk ka qenë akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri në kohën e leshimit të kësaj certifikate ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri, certifikata ISO 9001:2015, me nr. SMC20240328ALCS e paraqitur nga operatori Compitel Sh.p.k nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.2 të kriterëve të kualifikimit, pasi është leshuar nga një subjekt i cili në momentin e leshimit të kësaj certifikate nuk ka qenë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga DPA.

3. Katalogu (Maxus T90 EV dhe Volkswagen ID 3) Katalogu/broshura e automjetit Volkswagen ID 3 rezulton se është shkarkuar nga faqja e internetit https://www.volkswagen.co.uk/idhub/content/dam/onehub_pkw/importers/gb/downloads/brochures/used-cars/id-3/id-3-brochure-pricelist-dec-20.pdf dhe është perkthyer në shqip nëpërmjet aplikacionit të perkthimit të motorrit të kerkimit Google

Katalogu/broshura e automjetit Maxus T90 EV Pickup Truck rezulton se është shkarkuar nga faqja e internetit <https://www.cyclecarriage.com/sg/-/media/jccl/maxus/files/brochures/t90ev/t90ev---brochure.pdf> dhe është perkthyer në shqip nëpërmjet aplikacionit të perkthimit të motorrit të kerkimit Google

Kataloget/broshurat e paraqitur nga operatori Compitel Sh.p.k për automjetet Volkswagen ID 3 dhe Maxus T90 EV Pickup Truck nuk janë në përputhje me pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, pasi të dy kataloget nuk janë perkthyer nga perkthyes të licensuar por janë perkthyer nëpërmjet motorrit të kerkimit Google. Si rrjedhojë perkthimi i shqip i katalogeve nuk është pajisur me vertetim perkthimi

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Tirana Auto Shpk**, me adresë: Tiranë Kashar Autostrada Tiranë Durrës, Kilometri 1, Rruga Dytësore, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **12 000 000** (dymbëdhjetë milion) **lekë pa Tvsh./** totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erinda Fino